



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIVJAKË

Nr. 7636 Prot.

Divjakë më 15.10.2024.

PROJEKT - VENDIM

Nr. 54, datë 15.10.2024.

**“PËR DISA SHTESA NË VKB NR. 8, DATË 26.02.2024,” PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRVENDOR PËR MENAXHIMIN E LANDFILLIT (PESHIMIN, DEPOZITIMIN & MIRMBAJTJEN E RRUGËS HYRËSE) NË IMPIANTIN E MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER”.**

Mbështetur në Ligjin Nr.139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, bazuar në nenet 3, 8,9, 14, 23, 32, 33,54 – gj, 64 pika c, si dhe në zbatim të Ligjit numer 10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane”, si dhe të Ligjit numer 10440, datë 07.07.2011, “Për vëlrësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, Vendimi i Keshillit të Ministrave numer 319, datë 03.05.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane”, dhe kërkeses numer 3080 prot, datë 22.09.2023 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tirane, si dhe në vendimin numer 52, datë 27.10.2023, “Për dhenien e dakortësisë për marrjen në përdorim të landfillit të mbetjeve urbane të administruara nga agjencia e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara Tirane”, si dhe në lidhje me shkresën me numer 600 prot, datë 26.09.2024, protokolluar nga institucioni ynë, me numer 7198 prot, datë 30.09.2024, i propozojmë Keshillit të Bashkisë Divjake, me datë 25.10.2024.

**PROPOZOJMË:**

1. Të miratoj disa shtesa në V.K.B-ne nr. 8, datë 26.02.2024, “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor për menaxhimin e landfillit (peshimin, depozitimin & mirmbajtjen e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier
2. Të miratojë Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Divjake, për të zhvilluar negociatat për rishikimin e marrëveshjes ndërvendore të Bashkisë të Qarkut Fier ku të përfshihet dhe procesi për evadimin i ujërave të filtruara (kulluara) nga vendi i depozitimit të mbetjeve për arsye se vaska e grumbullimit të ujërave të ndotura të mbetjeve të ngurta është mbushur mbi kapacitetin e saj dhe rrezikon të shkaktojë prishje të bordurave rrethuese që shërbejnë për mbajtjen në kontroll të këtyre ujërave duke rrezikuar ndotje të konsideruar për zonën rreth Landfillit të Qarkut Fier, (Processi shpenzimet e të cilit të përfshihen në marrëveshjen ndërvendore).

Agjencia e Shërbimeve Komunale

Drejtori

Çerçis Turhani

Spektori Juridik Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit të Aseteve  
Andi Bullari

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit

Xheladin Brahkola

KRYETARI  
JOSIF GORREA

Adresa: Sheshi “Santa Barbara”, Qendër Divjake, Nr. Tel: 037122031, email: bashkia.divjake@gmail.com

